



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 347 Prot.

Tiranë, më 19.03.2018

V E N D I M

Nr.14, Datë 19/03/2018

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES
VENDORE, BASHKIA KUÇOVË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT
PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kuçovë,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 90, datë 25.4.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kuçovë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kuçovë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 299/1 prot., datë 25.4.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 299/2 prot., datë 25.4.2017, “*Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Kuçovë*”, i është njoftuar Bashkisë Kuçovë.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 299/3 prot., datë 11.12.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kuçovë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat 20 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 4089 prot., datë 28.12.2017, “*Dërgim projekt raporti*”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke paraqitur sqarime dhe duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Kuçovë, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse të përfundojë procedurën e deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxjerrë aktet e deklarimit

➤ si nëpunës civil për punonjësit;

1. *****, punësuar në pozicionin “Drejtor i Burimeve Njerëzore”, emëruar me aktin nr. 07, dt 31.05.2004.
2. *****, punësuar në pozicionin “Specialiste për Pagat”, në datë 01.07.1993.
3. *****, punësuar në pozicionin “Specialist i Kontrollit të Territorit”, emëruar me aktin nr. 68 datë 14.09.2007.
4. *****, punësuar në pozicionin “Specialist Kontabiliteti”, emëruar me aktin nr. 15, datë 07.11.2009.
5. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës Sektori te Drejtoria e Koordinimit dhe Zhvillimit Strategjik”, emëruar me aktin nr. 05, datë 14.03.2003.
6. *****, punësuar në pozicionin “Specialist Mjedisi”, në datë 05.01.2010.
7. *****, punësuar në pozicionin “Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, emëruar me aktin nr. 62, datë 06.05.2013.
8. *****, punësuar në pozicionin “Specialiste, për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijve”, emëruar me aktin nr. 75, datë 01.10.2007.
9. *****, punësuar në pozicionin “Specialist për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje”, në datë 03.02.2010.
10. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Përkrahjes Sociale”, emëruar me aktin nr. 41, datë 16.08.2011.

➤ si nëpunës civilë në periudhë prove, për punonjësen *****, punësuar në pozicionin “Specialist, Drejtoria e Shërbimit Social”, emëruar me aktin nr. 11, datë 05.02.2014.

3. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit (17 raste) nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, sipas orientimeve në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të rregullohen pasojat, duke i ndërprerë marrëdhënien e punës dhe atë financiare me institucionin, punonjësve të emëruar në kundërshtim me

procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, “Përgjegjës i Sektorit të Arkiv Protokollit”, emëruar me aktin nr. 104, datë 07.04.2017.
2. *****, “Specialist i Planifikim Territorit”, emëruar me aktin nr. 26, datë 24.01.2017.
3. *****, “Drejtor, Drejtoria e të Ardhurave”, emëruar me aktin nr. 89, datë 13.03.2017.
4. *****, “Specialist, Drejtoria e Koordinimit dhe Zhvillimit Strategjik”, emëruar me aktin nr. 103, datë 07.04.2017.
5. *****, “Specialist, Drejtoria e Zhvillimit Rural”, emëruar me aktin nr. 294, datë 23.08.2016.
6. *****, “Specialist i Kontrollit Ushqimor”, emëruar me aktin nr. 390, datë 02.12.2016.
7. *****, “Specialist, Drejtoria Juridike”, emëruar me aktin nr. 118, datë 04.04.2016.
8. *****, “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit Social”, emëruar me aktin nr. 46, datë 29.02.2016.
9. *****, “Specialist i Përkrahjes Sociale”, emëruar me aktin nr. 95, datë 04.05.2016.
10. *****, “Specialist i Arkiv Protokollit”, Njësia Administrative Perondi, emëruar me aktin nr. 214, datë 16.09.2015.
11. *****, “Specialist i Ndhmës Ekonomike”, Njësia Administrative Perondi, emëruar me aktin nr. 214, datë 16.09.2015.
12. *****, “Specialist i Arkiv Protokollit”, Njësia Administrative Kozare, emëruar me aktin nr. 60, datë 31.3.2016.
13. *****, “Specialist Ndhma Ekonomike”, Njësia Administrative Kozare, emëruar me aktin nr. 213, datë 16.09.2015.

14. *****, “*Specialist i Arkiv Protokollit*”, Njësia Administrative Lumas, emëruar me aktin nr. 215, datë 16.09.2015.
 15. *****, “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, Njësia Administrative Lumas, emëruar me aktin nr. 215, datë 16.09.2015.
 16. *****, “*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 366, datë 08.11.2016.
 17. *****, “*Inspektor i Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 230, datë 06.10.2015.
- Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure, me qëllim që procesi i konstatimit si absolutisht të pavlefshëm të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.
 - Në zbatim të detyrimit ligjor, njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.
4. Të konstatohen si absolutisht të pavlefshme procedurat e plotësimit të pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtuese, pasi janë zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të rifilloj procesi në zbatim të plotë të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe procedurave ligjore që duhet të zbatohen në këtë rast.

Për të rregulluar pasojat, nga ana e Kryetarit të Bashkisë, të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshme, aktet e emërimit në këto pozicione pune për punonjësit, sipas pozicionit të punës dhe akteve të emërimit të nxjerra nga titullari i institucionit;

1. *****, emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve*”, me aktin nr. 160, datë 13.04.2016.
2. *****, emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Informimit të Publikut*”, me aktin nr. 267, datë 10.11.2015;

3. *****, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Publike”, me aktin nr. 35, datë 19.02.2016;
 4. *****, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve”, me aktin nr. 150, datë 04.04.2016;
 5. *****, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Territorit”, me aktin nr. 246, datë 20.10.2015;
 6. *****, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural” me aktin nr. 65, datë 14.11.2016;
 7. *****, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit, Kontrollit të Ushqimit dhe Veterinar”, me aktin nr. 9, datë 27.03.2017.
5. Njësia përgjegjëse, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, për punonjës të *****, i cili vijon të kryejë detyrat funksionale në pozicionin e tij të punës si specialist i auditit, duke evidentuar në aktin e largimit, faktin se, ai nuk i përmbush kriteret e posaçme, të parashikuara në pikën 2/ç, të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pasi nuk disponon certifikatën e auditimit ndërkohë që ka kaluar periudha 2 vjeçare, e kërkuar nga ligji për auditin. Pozicioni i tij i punës, të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
6. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara me ligj (*analisti i punës, eprori direkt dhe drejtori i përgjithshëm*), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi si dhe udhëzimit nr. 1 datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse.

Për plotësimin e këtij detyrimi, njësia përgjegjëse, të zbatojë orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, si një detyrim ligjor që rrjedh prej ligjit që

rregullon funksionimin e njësive vendore, i cili ka përcaktuar vitin 2018, si afatin e strukturimit përfundimtar të këtyre njësive, pas implementimit të reformës territoriale dhe ndërkohë, një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse, të njoftojë të gjithë subjektet që ligji i ngarkon me administrimin e aspekteve të veçanta të shërbimit civil.

7. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përfundojë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, si dhe të ndjekë procesin në të ardhmen për realizimin e tij, brenda afateve.

Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

Të njoftohen të gjithë subjektet që kanë lidhje me këtë proces në rolin e zyrtarit raportues/zyrtarit kundërfirmues/zyrtarit autorizues.

8. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
10. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kuçovë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
11. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kuçovë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni

për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha